

Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen: Fillimi më i mirë në jetë.

Raport



European Association of
Service providers for
Persons with Disabilities

Raporti “Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen” është koordinuar nga **EASPD**.



Ky raport është miratuar nga organizatat e mëposhtme:



Raport i përbashkët

Shoqata Europiane e Ofruesve të Shërbimeve për Personat me Aftësi të Kufizuara (EASPD) promovon pikëpamjet e mbi 20,000 ofruesve të shërbimeve sociale dhe shoqatave ombrellë dhe mundësi për personat me aftësi të kufizuara nëpërmjet sistemeve të shërbimeve efektive dhe me cilësi të lartë.

Ky dokument u hartua nga Forumi Anëtar i EASPD për Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme (ECI MF) dhe u finalizua duke u konsultuar me shumë rrjete dhe organizata aktive për të drejtat e fëmijëve dhe familjeve dhe personat me aftësi të kufizuara, të cilët i falenderojmë për kontributin e tyre.

Qëllimi i këtij dokumenti është të rrisë ndërgjegjësimin mbi Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen, të informojë se pse është e nevojshme ajo, të evidentojë sfidat kryesore dhe të formulojë rekomandime për Bashkimin European (BE) dhe shtetet e tij anëtare për të krijuar sisteme cilësore të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme. Synimi ynë është të advokojmë së bashku për të drejtën e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme për fëmijët dhe familjet e tyre. Ky dokument është i hapur për miratimin nga organizatat europiane dhe ndërkombëtare.

ECI?



1

Çfarë është Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen?

Hulumtimet e neuroshkencës vërtetojnë se përvojat në Fëmijërinë e Hershme ofrojnë baza të forta për të mësuarin, sjelljen, shëndetin fizik dhe mendor për të ardhmen. Zhvillimi i hershëm i aftësive njohëse, emocionale dhe sociale janë tregues të rëndësishëm për zhvillimin e mëvonshëm të fëmijës. Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme është një fushë e shërbimeve të individualizuara që përqëndrohen te foshnjat dhe fëmijët e vegjël (0-3 vjeç dhe 0-6 vjeç) dhe familjet e tyre. Kjo ndërhyrje ka si synim të ndihmojë në identifikimin, parandalimin, kapërcimin ose minimizimin e situatave me risk të lartë. Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme nxit arritjen e potencialit të fëmijës, dhe, po ashtu, forcimin dhe mirëqenien e familjes. Këto shërbime janë veçanërisht kritike për fëmijët me vonesa në zhvillim, me vështirësi fizike, intelektuale, shqisore ose kushte, të tilla si: çrregullimi i spektrit të autizmit, probleme të shëndetit mendor, etj.

Aktivitetet e tyre bazohen në nevojat e familjes dhe fëmijëve, të cilat duhen të ofrohen në mjedisin natyror me pjesëmarrjen aktive të prindërve ose kujdestarit, duke ndjekur qasjen midis dy brezave, me qëllim për të punuar njëkohësisht me fëmijën dhe prindin. Ato duhet të përfshijnë vlerësimin e nevojave të fëmijës dhe anëtarëve të familjes, krijimin e planeve të individualizuara të shërbimit familjar, ofrimin e shërbimeve të rregullta sipas nevojës duke përfshirë terapinë e të folurit, fizioterapinë, programet e komunikimit, socializimit, psikoterapi dhe këshillim për prindërit.

Shërbimet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen janë elemente kyç në procesin e deinstitutionalizimit pasi fuqizojnë familjen, parandalojnë zhvendosjen e fëmijëve në institucion dhe nxisin përfshirjen në arsim. Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme ofron shërbime të integruara dhe ndërdisiplinore, me pjesëmarrjen e plotë të sistemit shëndetësor, social, arsimor dhe të gjitha disiplinave përkatëse në mbështetje të fëmijëve dhe familjes.



Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen është...

- **E hershme dhe e vazhdueshme.** Punohet me fëmijën menjëherë pas lindjes ose sa më shpejt të jetë e mundur. Vlerësimi i hershëm është i rëndësishëm për të siguruar që fëmija dhe familja të marrin mbështetjen e nevojshme me ndikim pozitiv maksimal.
- **Me në qendër familjen.** Familjet janë partner të barabartë në planifikimin dhe zbatimin e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e hershme. Ndërhyrja duhet të hartohet rreth nevojave dhe prioritetit të fëmijës dhe familjes. Kështu marrëdhënia me familjen është thelbësore për arritjen e rezultateve të suksesshme. Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme mbështet familjet dhe i orienton ato të përqëndrohen në zhvillimin e fëmijës së tyre, të njohin të drejtat e tyre dhe marrjen e vendimeve për mirëqënien e fëmijës.
- **E bazuar në modelin social të aftësisë së kufizuar.** Në vend që të trajtojë vetëm fushat e nevojës së fëmijës, Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme, gjithashtu, fokusohet në vlerësimin e pikave të forta dhe mirëqënies së familjes, zhvillimin e mëtejshëm të fëmijës dhe rrethin mbështetës familjar.
- **Intensive.** Mbështetja mund të jetë e shpeshtë, në varësi të nevojave të fëmijës dhe familjes. Mund të aplikohet në ambientet e shtëpisë dhe në mjediset e përditshme që frekuenton fëmija.
- **E aksesueshme.** Shërbimet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme për të gjithë, të përbalueshme për çdo familje dhe shërbimi të ofrohet sa më afër të jetë e mundur me vendbanimin e familjarëve.
- **Transdisiplinore, e integruar dhe e bazuar në ekip.** Familjet mbështeten nga profesionistët e sektorëve të ndryshëm që janë pjesë e ekipit për të ofruar shërbim të integruar të vlerësimit, planet e individualizuara të shërbimit dhe vizitave në familje me një pikë kontakti për çdo familje, siç është Koordinatori i Rastit.
- **E individualizuar dhe e bazuar në evidenca.** Aktivitetet e programit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme janë të ndërtuara mbi nevojat, prioritetet e fëmijës dhe familjes. Aktivitetet bazohen në rezultatet e kërkimeve shkencore për zhvillimin, të mësuarit, komunikimin dhe ndërhyrjen efektive për kushte specifike apo aftësi të kufizuara të ndryshme ndërmjet monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm.
- **E bazuar në interesin dhe pjesëmarrjen e fëmijës.** Profesionistët trajnohen për metodat miqësore të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme për të krijuar bashkëpunim me fëmijën, duke marrë në konsideratë reagimet e fëmijës përfshirë reagimet emocionale dhe sinjalet jo verbale të nevojës për rezistencë. Interesat më të larta duhet të vlerësohen bazuar në cilësinë e jetës së fëmijës, në marrëveshjet me prindërit dhe jo thjesht të fokusohet në eliminimin ose reduktimin e efekteve që sjell vështirësia.

2

Pse është e rëndësishme Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme?

Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë më shumë predispozitë për t'u vendosur në kujdes institucional sesa bashkëmoshatarët e tyre pa aftësi të kufizuara. Institucionalizimi e ndan fëmijën nga komuniteti i tij dhe ndihmon negativisht në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve. Përkujdesja në institucion nuk mund të sigurojë stabilitetin, sigurinë dhe ndjenjën e dashurisë që një fëmijë mund të marrë në familje. Disa prindër e vendosin fëmijën e tyre në një institucion sepse nuk janë të sigurt se si të trajtojnë aftësinë e kufizuar të fëmijës së tyre ose të plotësojnë nevojat e tyre. Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen ka si synim të fuqizojë prindërit duke i mbështetur ata në përmbushjen e rolit të tyre.

Aftësia e kufizuar rrit rrezikun e varfërisë dhe përjashtimit social, të përkeqësuar nga aksesit i pabarabartë në shërbimet kryesore. Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme me në qendër familjen mund të luajë një rol të madh në formësimin e jetës së fëmijëve, duke përfshirë shëndetin dhe mirëqenien mendore. Nisja e trajtimit të aftësive të kufizuara sa më shpejt që të jetë e mundur, mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në aftësinë e një fëmije për të mësuar aftësi të reja dhe për të përmirësuar suksesin e tij në shkollë dhe në jetë. Në këtë mënyrë, Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme me në qendër familjen është e dobishme për fëmijën, për familjen dhe për të gjithë komunitetin.

Përfitimet për fëmijën:

Zbulimi i hershëm i vonësive në zhvillim ose aftësive të kufizuara: Fëmijët kanë zhvillim të shpejtë të trurit dhe neuroplasticitetin në vitet e tyre të para. Gjatë kësaj periudhe shërbimet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen mund të arrijnë ndikimin maksimal në adresimin e rrisqeve, vonësive zhvillimore dhe dëmtimeve të tjera. Shërbimet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen kanë rezultate të qëndrueshme dhe ndihmojnë në arritjen e potencialit të plotë të fëmijës.

Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme me në qendër familjen promovon mirëqenien e fëmijëve. Mirëqenia e fëmijës mund të përfshijë shëndet të mirë, ushqim, higjienë, shëndet mendor, aftësi perceptuese, njohëse, gjuhësore, motorike, socio-emocionale dhe përshtatëse.

Gatishmëri më të mirë për shkollën. Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen lehtëson përfshirjen në arsimin e përgjithshëm parashkollor, përshtatjen në mjedise arsimore gjithëpërfshirëse, me më pak braktisje të shkollës dhe rezultate më të mira arsimore në të ardhmen.

- **Mundësi më të mira për të ardhmen:** Përfshirja në shërbimet të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme dhe arsimin gjithëpërfshirës mund të çojë në shanse më të larta për pjesëmarrje në shoqëri dhe punësim.

Përfitimet për familjen:

Parandalimi i braktisjes dhe institucionalizimit, duke mbështetur krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme dhe të sigurta fëmijë-prind dhe shërbime mbështetëse të përbalueshme dhe të aksesueshme, të përshtatura për nevojat e familjes.

Ndikimi pozitiv i prindërve në zhvillimin e fëmijës së tyre, nëpërmjet një qasjeje fuqizuese të bazuar në njohuritë dhe aftësitë e tyre për zhvillimin dhe kujdesin e fëmijës, të cilat forcohen gjatë ndërhyrjes;

Rritja e besimit dhe një ndjenjë kontrolli mbi jetën e tyre. Prindërit mësojnë se si të jenë partnerë aktivë dhe për të advokuar në lidhje me plotësimin e nevojave të fëmijës së tyre;

Përmirësimi i shëndetit mendor. Më pak stres dhe ankth për prindërit dhe inkurajimin për të ndërtuar marrëdhënie më të mira, brenda njësisë familjare duke mbështetur të gjithë familjen, më pak ndjenja izolimi dhe forcim të rrjeteve të mbështetjes sociale;

Përfitimet për popullatën:

Kthimi i investimit. Programet me cilësi të lartë që ofrohen nga lindja deri në moshën pesë vjeç për fëmijët e disavatazuar mund të ofrojnë një normë të përgjithshme të zhvillimit prej 13% në vit (Heckman, 2016).

Qasja parandaluese. Shërbimet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen mund të zvogëlojnë nevojën e ardhshme për mbështetje dhe shërbime rehabilitimi dhe në këtë mënyrë do të minimizojnë presionin mbi kujdesin publik shëndetësor, arsimin dhe shërbimet e mbrojtjes sociale.

Komunitete reziliente. Komunitetet që e kanë prioritet Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen janë më të orientuara drejt së ardhmes dhe ofrojnë mjedise mbështetëse për fëmijët dhe të rinjtë.

Më pak përjashtim social. Ndërhyrja e Hershme me në Qendër Familjen ndihmon në zvogëlimin e risqeve që fëmijët të ndjekin arsimin special, përsëritjen e klasës, prindërimin e hershëm dhe varësinë afatgjatë nga programet e mbrojtjes sociale dhe institucionalizimin në jetën adulte.

Kontribut pozitiv në shoqëri. Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen hap mundësi për fëmijët dhe i ndihmon ata të zhvillojnë personalitetin e tyre dhe të arrijnë të kenë një jetë të pavarur.

Barazia dhe reduktimi i varfërisë. Ndërhyrja në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen ndihmon në krijimin e një shoqërie më të barabartë, më të pjekur dhe harmonike.

Çfarë ndodh pa Ndërhyrjen e Hershme me në Qendër Familjen?

Në shumicën e vendeve nuk ekziston një sistem i Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen, që të jetë i përballeshëm dhe i disponueshëm për të gjitha familjet dhe fëmijët, kjo mund të ndihmojë në shpjegimin e përbindës së lartë të fëmijëve dhe të rriturve që jetojnë në institucione (mbi 1 milion në vendet anëtare të BE-së).

Pa mbështetje cilësore familjet janë në rrisht më të madh të përjashtimit social dhe duhet të plotësojnë boshllëkun e ofrimit të shërbimeve me burimet e tyre financiare, kohën dhe energjinë e tyre. Kjo i bën shoqëritë më të pabarabarta, me rrisht më të madh që fëmijët të vendosen në institucione. Pasojat për këta fëmijë mund të ndryshojnë, por kanë të bëjnë me rrisht më të larta të një zhvillimi më të ulët të aftësive njohëse dhe sociale, shëndet dhe ushqim të pamjaftueshëm, përjashtim arsimor, institucionalizim të të rriturve, më pak mundësi për përfshirje në aktivitetet e komunitetit dhe arritje të potencialit të tyre të maksimal.



3

Sistemet Kombëtare të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen: Sfidat dhe zgjidhjet

Në këtë seksion mund të gjeni disa nga sfidat më të zakonshme në krijimin e sistemeve funksionale të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen dhe çfarë nevojitet në nivel kombëtar dhe në BE.

Përkufizimi dhe objektivat

I Sfida kryesore:

Politikëbërësve dhe profesionistëve shpesh u mungon një kuptueshmëri e përbashkët e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme cilësore, dhe asaj që ajo përfshin.

I Zgjidhjet dhe rekomandimet kombëtare:

- **Hartoni udhëzime dhe procedura** të qarta për programet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme që mbulojnë tema, të tilla si: aksesit në shërbime, identifikimi, vlerësimi, përshtatshmëria, cilësia e shërbimit, gjurmimi dhe monitorimi i familjes/fëmijës, me një vizion dhe mirëkuptim të përbashkët midis vendimmarrësve për Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme dhe përfitimet e saj.
- **Krijoni platforma dhe fushata** për të informuar politikëbërësit dhe profesionistët kombëtarë për Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen.

I Zgjidhjet dhe rekomandimet e BE:

- Zhvillimi i **udhëzimeve të BE-së për sistemet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme** për shtetet anëtare dhe vendet anëtare për t'i marrë në konsideratë iniciativat përkatëse në fushat e të drejtave të fëmijëve, të drejtave të familjes, të drejtave të aftësisë së kufizuar dhe deinstitutionalizimit.

Situata aktuale

I Sfida kryesore:

Të dhëna të varfra ose aspak të dhëna në shumicën e vendeve për disponueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve ekzistuese të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.

I Zgjidhjet dhe rekomandimet kombëtare:

- Kryeni një **analizë të situatës së Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme**, duke hartuar përmbajtjen, metodat dhe praktikatat e mira të programeve ekzistuese të kësaj ndërhyrjeje.
- Inkurajoni të gjitha programet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme që të përfshijnë **procedurat e monitorimit dhe vlerësimit** të brendshëm dhe të hartojnë programe vjetore dhe raporte financiare.

I Zgjidhjet dhe rekomandimet e BE-së:

Përpiloni dhe rishikoni përkufizimet, kornizat, sistemet dhe praktikatat më të mira ekzistuese për Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme në një **studim në vendet e Bashkimit European mbi politikatat dhe praktikatat** e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen. Kjo do të përfshijë monitorimin dhe vlerësimin, gjendjen e zbatimit të vlerësimit të zhvillimit dhe procedurat e shërbimit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen.



Korniza ligjore dhe financimi

I Sfidat kryesore:

- **Mungesa e kornizave legjislative dhe planeve strategjike** për të rregulluar, organizuar dhe garantuar shërbime të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen me cilësi të lartë dhe të qëndrueshme.
- **Financimi** jo adekuat i qëndrueshëm dhe i decentralizuar për shërbimet e kësaj ndërhyrjeje, veçanërisht për OJF-të që ofrojnë Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme me në Qendër Familjen.
- Ministrive dhe organizatave të ndryshme të përfshira në Ndërhyrjen e Fëmijërisë së Hershme u mungojnë **sistemet e koordinimit të ndërhyrjes** që do të mundësojnë zhvillimin e organizatave dhe shërbimeve të integruara të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme. Legjislacioni për grupmoshën 0-3 vjeç shpesh bie vetëm nën sektorin mjekësor ose të shëndetit publik.
- Nivele të ndryshueshme të aksesit, disponueshmërisë dhe përballueshmërisë së shërbimeve të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme në zona të ndryshme gjeografike, dhe veçanërisht në zonat me të ardhura të ulëta, të largëta dhe rurale.
- Mungesa e **monitorimit të zhvillimit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme dhe instrumentat e vlerësimit** që janë përshtatur në kulturë dhe gjuhë, që kanë vlefshmëri dhe besueshmëri psikometrike.
- Mungesa e **shërbimeve cilësore dhe standardeve të personelit**, e lidhur me mungesën e trajnimit adekuat për disa nevoja specifike mbështetëse, si çrregullimi i spektrit të autizmit.
- Mungesa e mekanizmave për: supervizimin e shërbimit, **monitorimin, vlerësimin, matjen e impaktit dhe kontrollin cilësor**.
- **Burokracia** që e bën të vështirë për familjet aksesin në shërbimet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme nga mungesa e mbështetjes financiare.

I Zgjidhjet dhe rekomandimet kombëtare:

- Krijimi i një **departamenti dhe komiteti teknik koordinues** shumë-sektorial të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme dhe një organ këshillimor të nivelit të lartë për **hartimin dhe zbatimin e një sistemi koherent kombëtar**, duke përfshirë trajnimin para dhe gjatë shërbimit që përfshin të gjithë aktorët përkatës, përfshirë familjet, organizatat për të drejtat e fëmijëve, ofruesit e shërbimeve dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile.
- Përgatitni një **plan strategjik kombëtar të integruar për shërbimet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme të përqëndruara te familja**, me qëllim për të arritur një vizion, mision dhe objektiva të përbashkëta, në bashkëpunim me palët e interesuara, duke përfshirë ofruesit e shërbimeve, familjet dhe organizatat për të drejtat e fëmijëve, që:
 - **Siguron disponueshmërinë e shërbimeve, aksesin e shërbimeve dhe procedurave.**
 - Përfshin kornizat kombëtare qeveritare, **financimin nga BE** dhe diversifikimin e burimeve të financimit.
 - Përfshin **udhëzime** se si të sigurohet koordinimi dhe si të zhvillohen shërbime të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.
 - Përfshin **informacion të qartë, të hershëm dhe të thjeshtë në lidhje me shqyrtimin e zhvillimit të përshtatshmërisë dhe proceset e referimit për të gjithë fëmijët dhe familjet, duke përfshirë ato me fëmijë me nevoja komplekse për mbështetje.**
 - Përfshin një **kornizë për sigurimin e cilësisë.**
 - Ofron një **sistem për monitorimin, vlerësimin, mbledhjen e të dhënave, analizën dhe raportimin e shërbimeve të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.**

I Zgjidhjet dhe rekomandimet e BE-së:

- **Inkurajoni shtetet anëtare, që të përdorin Instrumentin e Mbështetjes Teknike për të zbatuar reformat e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme** përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Komisionit për Mbështetjen e Reformës Strukturore.
- Nxisni **shkëmbimin e informacionit dhe përvojës mbi ndërhyrjen** ndërmjet ministrive dhe palëve të interesuara.
- Përfshini rekomandime për krijimin e **planeve strategjike të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme** si pjesë e **nismave të BE-së për fëmijët, aftësinë e kufizuara dhe kujdesin** (në kuadër të Semestrit Europian, Strategjisë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Garancisë për Fëmijët dhe Strategjisë së Kujdesit të BE-së).
- Përfshini **monitorimin dhe vlerësimin e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme** si pjesë e Kornizës Europiane të Monitorimit të Garancisë për Fëmijët dhe Semestrit Evropian .

Trajnimi dhe kushtet e punës

I Sfidat kryesore:

- Shumë vendeve u mungon një sistem shërbimi për trajnimin e profesionistëve dhe programet universitare për profesionistët që punojnë në sektorin e ndërhyrjes së hershme.
- Kushtet jo të mira të punës gjenden shpesh në fushën e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme dhe ato mund të dëmtojnë vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

I Zgjidhjet dhe rekomandimet kombëtare:

- Zhvillimi i një **sistemi trajnimi** gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm, duke përfshirë krijimin e kurseve të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) dhe universitare, si dhe trajnimit në punë për të gjithë profesionistët e përfshirë në sektorin Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme, me planifikim dhe financim për zbatim.
- Bëni **të detyrueshëm** një trajnim periodik në punë dhe ritrajnim për profesionistët që punojnë me fëmijët dhe familjet, përfshirë mekanizma mbikëqyrjeje, montorimi, mbështetjeje dhe inkurajoni shkëmbimet dhe grupet mbështetëse të kolegëve.
- Siguroni **kushte** të mira **në punë**, disponueshmëri të mbikëqyrjes dhe mbështetjes reflektuese, asistencë për zhvillimin e ekipeve ndërdisiplinore dhe rritje të niveleve transdisiplinore dhe të përshtatshme të njohjes për personelin e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.

I Zgjidhjet dhe rekomandimet e BE-së:

- Krijoni një **platformë për trajnimin** në Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme, me MOOCs, prezantime dhe trajnime online të disponueshme në të gjitha gjuhët e vendeve anëtare të BE-së.
- Mbështesni zhvillimin dhe zbatimin e **planeve kombëtare të trajnimit** të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme përmes sistemeve të trajnimit të vazhdueshme para dhe gjatë shërbimit.
- Siguroni **fonde për ndarjen e praktikave të mira**, nëpërmjet shkëmbimit të organizatave, vizitave, konferencave, vizitave studimore ndërkombëtare në organizata shumëfunktionale të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme dhe financimit të kërkimit shkencor mbi Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme, në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-së, nëpërmjet programeve, të tilla si Erasmus+ dhe Horizon Europe.



Si pjesë e iniciativës sonë, po mbledhim miratime për raportin nga Organizatat Evropiane dhe Ndërkombëtare.

Nëse dëshironi të tregoni mbështetjen tuaj për raportin, regjistrohuni me emrin e organizatës suaj më poshtë përmes formularit të Google!

Këtu është formulari i Google:

<https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSfqIL21yDeRnns-Gp3vxmF93tvt0nQPnJSuM-f9Qn1T86bmYA/viewform>





EUROPEAN ASSOCIATION OF SERVICE PROVIDERS FOR PERSONS WITH DISABILITIES
Handelsstraat / Rue du Commerce 72 | B- 1040 Brussels - Belgium
+32(0) 2 233 77 20 | info@easpd.eu | www.easpd.eu

Follow our work on



Easpd Brussels



@EASPD_Brussels



EASPD



EASPD

Copyright © EASPD 2022

All rights reserved. No part of this publication may be reproduced, stored in or introduced into a retrieval system without the prior permission of the copyright.



**Co-funded by
the European Union**